# UDHËZIM

# PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT TË APLIKIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË PUBLIK DHE PRIVAT (IAL)

## Raundi i dytë

### Viti akademik 2016-2017

Për të vazhduar garën për të fitimin e një të drejte studimi në Institucionet e Arsimit të Lartë Publik dhe Privat të vendit, çdo maturant/kandidat që kërkon të vazhdojë studimet e larta, **duhet të plotësojë Formularin e aplikimit për në IAL (Raundi i dytë), on-line** në çdo mjedis ku ka akses interneti.
Të drejtën për të aplikuar me këtë formular në raundin e dytë e kanë maturantët/kandidatët e mëposhtëm:

1. Të gjithë maturantët /kandidatët të cilët kanë plotësuar formularin A1 ose A1Z që nuk kishin detyrime për provimet e maturës shtetërore ose rezultojnë kalues në provimet e maturës shtetërore në sesionin e dytë, të vjeshtës
2. Të gjithë maturantët /kandidatët të cilët kanë plotësuar formularin A1 ose A1Z dhe rezultojnë kalues në provimet e maturës shtetërore në sesionin e parë, të muajit qershor të cilët:

    a. Nuk kanë arritur të aplikojnë në raundin e parë për arsye të ndryshme
    b. Kanë aplikuar në raundin e parë por nuk janë shpallur fitues në asnjërën prej preferencave të përzgjedhura
    c. Kanë aplikuar në raundin e parë dhe janë shpallur fitues në njërën nga preferencat e përzgjedhura por nuk janë regjistruar në asnjërin prej programeve të studimit ku janë shpallur fitues

**KUJDES:** Nëse ndonjë maturant/kandidat i shpallur fitues në raundin e parë, dhe për më tepër i regjistruar, përpiqet të aplikojë për përzgjedhjen e preferencave në raundin e dytë, sistemi nuk e lejon ta bëjë një gjë të tillë duke i dhënë mesazhin si psh:
Ju nuk mund te aplikoni sepse jeni te regjistruar tek: Inxhinieri Mekanike.

Vëmë në dukje se maturantët/kandidatët, të cilët nuk kanë aplikuar në raundin e parë me Formularin e Aplikimit në IAL dhe për rrjedhojë është hera e parë që përzgjedhin programet e tyre të studimit preferencialë, duhet fillimit të ndjekin procedurat e mëposhtme:

- Të shkarkojnë nga faqja zyrtare të AKP me adresë: www.akp.gov.al ***Faturën për arkëtim për plotësimin e formularit për në IAL*** dhe më pas ta printojnë.
- Të paraqiten në zyrat e Postës Shqiptare apo pranë çdonjërit prej filialeve të bankave të nivelit të dytë për të kryer pagesën e tarifës për formularin e aplikimit në IAL, Matura Shtetërore 2016
- Të dorëzojë mandat pagesën e kryer të tarifës në drejtorinë e shkollës ku ka kryer aplikimin me formularin A1/A1Z, që shkolla ti hedhë në Portalin e Maturës online mesataren sipas VKM-së

**Kujdes**: **Maturantët /kandidatët që kanë aplikuar në raundin e parë nuk duhet të kryejnë një pagese tjetër tarife**.

Për aplikimin e këtij formulari online do të veprohet si më poshtë vijon:

Secili maturant/kandidat që ka kryer pagesën për aplikimin me formularin për në IAL (Raundi i dytë), në zyrat e Postës Shqiptare apo në secilën bankë të nivelit të dytë, ka dorëzuar në shkollën e tij mandat pagesën përkatëse, mund të aplikojë nga çdo mjedis ku ka akses interneti, shkollë, zyrë, shtëpi, kafe internet, etj.

Për të hyrë në portalin e për aplikim adresa që duhet përdorur është si më poshtë:

**matura.akp.gov.al**

Fillimisht na shfaqet faqja kryesore e portalit si më poshtë:




Maturanti/kandidati klikon te butoni 

në pjesën qendrore të dritares dialoguese . Pas këtij veprimi na shfaqet dritarja e mëposhtme:




Te fushat e shfaqura duhet të plotësohen të dhënat e kërkuara duke patur kujdes. Në fushën “**Karta e Identitetit**” duhet të vendoset **numri personal** (kliko mbi fjalën shembull dhe do të shfaqet një kartë identiteti ilustruese. Numri personal i kartës, i kornizuar si më poshtë, gjëndet në pjesën e poshtme në të djathtë të saj).




Pasi të keni plotësuar fushat e mësipërme, duhet bërë kujdes që informacioni të jetë i saktë sepse përdoret për verifikime të mëvonshme. Pas kësaj klikoni te butoni .




Nëse të dhënat tuaja nuk janë të sakta do të shfaqet mesazhi "**Maturanti nuk përkon me kartën e identitetit**", si më poshtë:




Fillimisht kontrolloni edhe njëherë saktësinë e të dhënave që keni shkruar dhe klikoni përsëri te butoni Identifikohu . ***Nëse ju shfaqet sërish i njëjti mesazh, kjo do të thotë se për të bërë aplikimin online ju duhet të paraqiteni detyrimisht pranë Drejtorisë/Zyrës Arsimore të rrethit tuaj me dokumentin tuaj personal të identifikimit për të kryer aplikimin nën kujdesin e përfaqësuesit të Drejtorisë***.

Nëse të dhënat tuaja janë të sakta do të vazhdoni procedurat e aplikimit online sipas hapave të mëposhtme.

Pas klikimit të butonit 

shfaqen dritaret e mëposhtme sipas rastit:

**<u>Rasti I</u>** Maturanti/kandidati nuk ka kryer pagesën dhe për rrjedhojë nuk ka të hedhur në sistem notën mesatare sipas VKM Nr. 407, datë 1.6.2016. Në këtë rast i paraqitet mesazhi :



Maturanti nuk mund të aplikojë për formularin për në IAL (Raundi i dytë) sepse në sistemin informatik nuk ka të pasqyruar notën mesatare.




Në këto kushte brenda datave të aplikimit për DAR/ZA tuaj duhet të kryeni pagesën sipas procedurave të përshkruara më lart dhe të paraqiteni në shkollë për hedhjen e notës mesatare në sistem. Pas hedhjes së notës mesatare në sistem mund të aplikoni për përzgjedhjen e programeve të studimit.

**<u>Rasti II.</u>** Maturanti/kandidati e ka kryer pagesën dhe ka të hedhur në sistem notën mesatare sipas VKM Nr. 407, datë 1.6.2016. Maturanti mund ta plotësojë formularin pavarësisht nga nota mesatare që ka. Në varësi të notës mesatare dallohen rastet e mëposhtme:

a) Nëse nota mesatare e hedhur në sistem është më e madhe ose e barabartë me 6 (gjashtë) atij maturanti do ti shfaqet lista me të gjitha programet e studimit që IAL –të Publike dhe Private ofrojnë për vitin akademik 2016-2017 që kanë kuota bosh në dispozicion për këtë raund, si ne figurën më poshtë:




1. Në pjesën e sipërme maturantit i shfaqen të gjitha gjeneralitetet, nota mesatare e shkollës së mesme si dhe notat e marra gjatë provimeve të Maturës Shtetërore.
2. Poshtë të dhënave personale të maturantit është një Drop Down List e cila i jep mundësinë atij që të përzgjedhë njërin nga programet e studimit që ofrohen nga IAL-të publike dhe private për vitin akademik të ardhshëm 2016-2017.
3. Për ta përzgjedhur një program studimi ai duhet të klikojë mbi butonin 

4. Sistemi informatik nuk të lejon që të përzgjidhem më shumë se 10 preferenca, por lejon që të fshihet ndonjëra prej tyre si dhe të rirenditen ato. Nëse duhet të heqim një program studimi mjafton të klikojmë tek butoni "**Hiqe**" ndërsa për t'i rirenditur, në kutizat anësore duhet të shtypim renditjen e re te propozuar dhe më pas klikojmë mbi butonin poshtë "**Ruaj Renditjen"** (**Kujdes!** Gjatë vendosjes se renditjes se re nuk duhet te kemi përsëritje numrash)




| Preferenca | | Programi i Studimit | Kodi | Universiteti |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Hiqe | Matematikë | 008 | UNIVERSITETI I TIRANËS |
| 2 | Hiqe | Inxhinieri Elektronike | 083 | UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS |
| 3 | Hiqe | Filozofi-Sociologji | 136 | UNIVERSITETI I ELBASANIT "Aleksandër Xhuvani" |
| 4 | Hiqe | Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital | 295 | UNIVERSITETI PRIVAT EPOKA |
| 5 | Hiqe | Arkitekturë dhe Dizain Urban | 347 | UNIVERSITETI POLIS |
| 6 | Hiqe | Farmaci | 394 | UNIVERSITETI PRIVAT ALBANIAN UNIVERSITY |
| 7 | Hiqe | Shkenca Kompjuterike | 420 | UNIVERSITY OF NEW YORK TIRANA |
| 8 | Hiqe | Menaxhim Biznesi | 425 | UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS |
| 9 | Hiqe | Fizioterapi | 234 | UNIVERSITETI I DURRËSIT "Aleksandër Moisiu" |
| 10 | Hiqe | Inxhinieri Navale | 196 | UNIVERSITETI I VLORËS "Ismail Qemali" |



5. Pas përzgjedhjes të programeve të studimit të preferuara maturanti/kandidati klikon mbi butonin 

.
6. Pas këtij hapi shfaqet një dritare tjetër dialoguese e cila i jep mundësinë maturantit të bëjë konvertimin e formularit të tij në formatin PDF. Për konvertimin dhe printimin e Formularit maturanti duhet të lexojë udhëzimet në fillim të dritares dialoguese.




7. Formulari mund të printohet nga maturanti/kandidati nëse dëshiron të ketë një kopje në letër të preferencave të përzgjedhura. Vëmë në dukje se printimi i formularit nga maturanti/kandidati nuk është i detyrueshëm. Për shtypjen në letër të formularit ndiqen hapat e mëposhtme:
8. Fillimisht eksportojmë formularin në formatin PDF si më poshtë:




Klikojmë tek butoni 


9. Për të lexuar skedarët PDF mund të përdoren programet Adobe Reader ose Foxit Reader.




10. Përzgjidhni opsionin **Open with** dhe më pas klikoni mbi butonin **OK.** Pasi hapet skedari maturanti mund ta printojë, nëse dëshiron, formularin e përzgjedhjeve të kryera nga vetë ai.



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE (AKP)

IAL APLIKIMI PËR NË ARSIMIN E LARTË

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Emri: | Emer | Gjinia: | Mashkull | Shkolla: | (1) AJET XHINDOLE, BERAT |
| Atesia: | Atesi | Vendlindja: | tr | Profili: | GJIMNAZ |
| Mbiemri: | Mbiemer | Datelindja: | 14/07/2016 | Nota Mesatare: | 5.15 |
| Mbaruar jashte: JO | | | | | |

| RENDITJA | UNIVERSITETI | PROGRAMI I STUDIMIT |
|---|---|---|
| 1 | UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS | Menaxhim Veterinar (2vjeçar) |

11. Pasi maturanti ka printuar ose jo (sipas dëshirës) formularin e preferencave të tij, ai largohet nga Portali i Maturës Shtetërore duke klikuar mbi butonin 

në pjesën e sipërme djathtas të dritares.



b) Nëse nota mesatare e hedhur në sistem është më e vogël se 6 (gjashtë) atij maturanti do ti shfaqet vetëm lista me programet e studimit dy vjeçare me karakter profesional  që IAL –të Publike dhe Private ofrojnë për vitin akademik 2016-2017 që kanë kuota bosh në dispozicion për këtë raund, si ne figurën më poshtë:



# Formulari i Aplikimit per ne IAL

**Emri** Emer
**Atësia** Atesi
**Mbiemri** Mbiemer
**Gjinia** Mashkull
**ID** 160100100058
**Datelindja** 14/07/2016

**Vendlindja** tr
**Shkolla e Mesme** (1) AJET XHINDOLE, BERAT
**Profili** GJIMNAZ

| | |
|---|---|
| Nota Mesatare | 5.15 |
| GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI, GJIMNAZ | 4.50 |
| MATEMATIKË, GJIMNAZ | 4.50 |
| GJEOGRAFI BËRTHAMË | 4.50 |
| FIZIKË ITALISHT | 4.50 |

**Programe Studimi**

-- Zgjidh --

-- Zgjidh --
063 - UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS - Menaxhim Veterinar (2vjeçar)
123 - UNIVERSITETI I ELBASANIT "Aleksandër Xhuvani" - Teknologji laboratori (2vjeçar)
236 - UNIVERSITETI I DURRËSIT "Aleksandër Moisiu" - Teknikë Elektrike (2 vjeçar)
237 - UNIVERSITETI I DURRËSIT "Aleksandër Moisiu" - Hidroteknikë Ujësjellës Kanalizime (2 vjeçar)
238 - UNIVERSITETI I DURRËSIT "Aleksandër Moisiu" - Asistencë Stomatologji (2 vjeçar)
239 - UNIVERSITETI I DURRËSIT "Aleksandër Moisiu" - Menaxhim Ndërtimi (2 vjeçar)
240 - UNIVERSITETI I DURRËSIT "Aleksandër Moisiu" - Menaxhim Transporti (2 vjeçar)
241 - UNIVERSITETI I DURRËSIT "Aleksandër Moisiu" - Asistencë Ligjore (2 vjeçar)
242 - UNIVERSITETI I DURRËSIT "Aleksandër Moisiu" - Asistencë Administrative (2 vjeçar)
243 - UNIVERSITETI I DURRËSIT "Aleksandër Moisiu" - Teknologji Automobilash (2 vjeçar)
244 - UNIVERSITETI I DURRËSIT "Aleksandër Moisiu" - Teknikë e Rrjeteve Kompjuterike (2 vjeçar)
245 - UNIVERSITETI I DURRËSIT "Aleksandër Moisiu" - Informatikë Praktike (2 vjeçar)
352 - UNIVERSITETI POLIS - Efiçencë Energjitike ( 2 vjeçar)
396 - KOLEGJI PROFESIONAL I TIRANËS - Teknologji Informacioni dhe Komunikimi (2 vjeçar)
397 - KOLEGJI PROFESIONAL I TIRANËS - Elektronikë (2 vjeçar)
398 - KOLEGJI PROFESIONAL I TIRANËS - Database dhe Web Design (2 vjeçar)
399 - KOLEGJI PROFESIONAL I TIRANËS - Elektro-Mekanikë (2 vjeçar)
400 - KOLEGJI PROFESIONAL I TIRANËS - Teknologji Automjetesh (2 vjeçar)
401 - KOLEGJI PROFESIONAL I TIRANËS - Mekatronikë (2 vjeçar)

Edhe kjo kategori maturantësh do të plotësojë formularin vetëm me këto programe studimi  dy vjeçare duke ndjekur hapat që shpjeguam më lart.

c) Për maturantët/kandidatët që dëshirojnë të aplikojnë pranë Universitetit të Mjekësisë Tiranë nota mesatare për programet e studimit të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike , që kanë kuota bosh në dispozicion për këtë raund, duhet të jetë më e madhe ose e barabartë me 8(tetë). Për programet Mjekësi e Përgjithshme, Farmaci dhe Stomatologji duhet te jetë më e madhe ose e barabartë me 8.5 (tetë pikë pesë). Pra për ato maturantë dhe kandidatë që nuk plotësojnë këto kushte të notave mesatare të llogaritura sipas VKM  Nr. 407, datë 1.6.2016, programet respektive nuk shfaqen në formularin që ata do të plotësojnë dhe për rrjedhojë ata nuk mund ti përzgjedhin këto programe studimi.